

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

**PROGRAMI
MËSIMOR**



ARSIMI FIGURATIV

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/00 dhe 44/02) dhe nenit 24 dhe 26 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta Zyrtare e RM” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06 dhe 51/07) ministri i Arsimit dhe Shkencës solli program mësimor për lëndën *arsim figurativ* për klasën e VII të arsimit tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e VII për arsimin nëntëvjeçar.

1. HYRJE

Lënda arsimit figurativ paraqet pjesë përbërëse të konceptit për arsimin fillor nëntëvjeçar. Mësohet si lëndë e obliguar edhe në periudhën e tretë të arsimit fillor, përkatësisht në klasën e VII - IX me nga një orë në javë, përkatësisht 36 orë në vit.

Arsimi figurativ ofron mundësi për fitimin e diturive të vazhdueshme dhe që përdoren dhe aftësi për shprehje figurative. Kjo i ndihmon nxënësit ta njohin botën dhe të integrohen në të.

Nëpërmjet mësimin për arsim figurativ nxitet zhvillimi psikomotorik, motivi, dhe zhvillimi intelektual i nxënësit, zhvillohet fantazia e tyre dhe ndjenja për vlerësim estetik. Nxënësi/nxënësit mëson të mbikëqyrë, të njohë vlerat artistike dhe të vendos lidhje me artin e cila do të jete prezente gjate gjithë jetës së saj/ tij.

Arsimi figurativ bazohet në procesin e ekzaminimit dhe krijimit. Ajo i shpreh dhe i ndjek fazat e zhvillimit të nxënësit për shprehjen dhe krijimin e tyre figurativ. Nga mësimdhënësi kërkohet qasje kreative dhe fleksibile në realizim të mësimin sipas interesit dhe aftësitë të nxënësit.

Aktivitetet e propozuara dhe metodat e programit mësimor mundëson integrimin e përmbajtjeve të programit për edukim figurativ me përmbajtjet e programeve për lëndët tjera obliguese dhe fakultative.

Shënim:

Në pajtim me dinamikën për vendosje të edukimit dhe arsimit fillor nëntëvjeçar, programi mësimor për nxënësit në klasën e VII të arsimit tëntëvjeçar nga viti shkollor 2008/2009 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VII të arsimit fillor nëntëvjeçar.

2 QËLLIMET PËR PERIUDHËN ZHVILLUESE PREJ KLASËS VII-IX

- të zgjeroj diturit e tij për gjuhën dhe shprehjen figurative;
- të zhvilloj interesimin, fantazinë dhe kreativitetin për shprehje figurative; - të shpreh vete dhe lirshëm diturit e tij, ndjenjat, përjetime dhe përshtypje, mendime dhe fantazinë, me ndihmën e gjuhës figurative;
- të përdor dituritë e fituara dhe aftësitë në shprehjen figurative;
- të kujdeset për zakonet e punës dhe kulturore – higjienike – teknike;
- të ndërtoj relacion pozitiv me trashëgimin kulturore nga bashkësitë etnike të ndryshme;
- të fitoj njohuri themelore nga historia e artit dhe teoria e artit figurativ;
- të pranoj natyrën dhe mjedisin në të cilin jeton si vlerë estetike, inspirim për shprehje figurative dhe vend për ndikim;
- të respektoj shprehjen figurative të tij dhe të tjerëve;
- të lirohet nga stresi, tensioni emocional nëpërmjet shprehjes figurative.

3 QËLLIMET E MËSIMIT PËR KLASËN E VII

Nxënësi/nxënësjja:

- të njohë nocionet figurative dhe të përdor terme të reja në mësimin e arsimit figurativ;
- të përdor materiale të ndryshme figurative dhe të përvetësojë teknika për vizatim, pikturim, formësim në hapësirë dhe modelim dhe dertim/krijim, grafikë, komunikime vizuale dhe dizajn në arsimin figurativ:
- ta zhvillojë aftësinë për mbikëqyrje analitike dhe vërejtja i formave të ngjashme dhe të ndryshme në natyrë dhe veprave artistike/figurative;
- të shqyrtojë, vërejë dhe zbatojë lloje dhe bujshmërinë e vijave dhe raportin e tyre;
- të fitojë njohuri për ngjyrat dhe raportet e tyre kolorite;
- ta zhvillojë ndjenjën elementare për hapësirë (e jashtme, e brendshme, natyrore dhe funksionale);
- të dijë të komponojë elementet figurative (vija, forma, ngjyra, vëllimi, spërfaqja) dhe të krijojë tërësi estetike;
- të mund të bëjë zgjedhje të idesë, aktivitetit dhe mjete dhe të krijojë krijim artistik/figurativ;
- të dijë verbalisht të sqarojë krijim figurativ të nxënësit ose vepër artistike dhe të nxitet në vlerësimin e tij estetik;
- të bëjë dallimin e veprave artistike në lëmi të ndryshme figurative (vizatim, pikturë, skulpturë, grafikë, arkitekturë);
- ti njohë mediat vizuale, mjetet dhe funksionin e tyre;
- të dijë ta shfrytëzojë teknikën kompjuterike për shprehjen figurative;
- ta zhvillojë interesimin për vlerat estetike të krijuara gjat historisë.

4. QËLLIME KONKRETE

VIZATIM (PËRAFËRSISHT 8 ORË)			
Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxenes / nxenesja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të perceptojë dallimin e dendësive lineare në ambientin natyror ; - të përdor vija me intensitet të ndryshëm; - të paraqet teksturë duke përdor vija me dendësi dhe drejtime të ndryshme; - të kompozoj sipërfaqe me vlerë të ndryshme teksture; - të ndërtoj kompozim me komponimin e vijave, teksturave, vlerave tonike dhe madhësive; - të përvetësoj procedurë teknike në vizatimin varësisht nga mjetet për vizatim; - të shpreh ritëm dhe kontrast të vijave dhe formave; - të përdor procedurë të fshirjes për fitim të tonit të ndryshëm dhe intensitet të ndryshëm të vijave; - të fitoj aftësi për përdorim të pigmentit si material figurativ; - të përvetësoj aftësi për përdorim të teknikave vizatim me tush lundues; - të njihet me veprat e tre autorëve të dalluar (të vendit dhe të huaj). <p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vërej dhe përdor në shprehjen e tij figurative, 	<p>Elementet figurative dhe parimet në vizatim</p> <p>Mjete për vizatim dhe përdorimi i tyre</p> <p>Vizatim</p> <p>Vlerësim estetik</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Dendësia e vijave (përsëritje) - Përdredhje - Vlerë tonike - Vlerë teksture - Gradacion - Sipërfaqe - Kompozim 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbikëqyrje (drejtpërdrejt ose përmes fotografisë dhe mjeteve tjera vizuale), shpresa gjeologjike, dukuri natyrore dhe mbi ta verën dallim të tonit, teksturës, dendësisë dhe karakterit të vijës; • Nëpërmjet vizatimit të vijave me intensitet të ndryshëm dhe gërshetim (shrafiturë) vizaton ambient urban dhe tregon sipërfaqe me vlerë tonike të ndryshme; • Me tush monokrome vizaton natyrë të vdekur dhe shpreh gradim të tonit, dritë – hije. • Vizaton motive nga ambienti në afërsi të cilat mundësojnë përdorim të vijës si teksturë, kotur (insekt, entier). • Vizaton njerëz dhe kafshë në grup dhe nëpërmjet vizatimit paraqet aktivitet dhe levizje (sportiste, valltar, kope). • Vizaton me pigment dhe ekzaminon procedurë të ndryshme. • Vizaton natyrë me stinët e ndryshme të vitit dhe tregon dukuri natyrore dhe lirshëm, në formë kreative kombinon elemente figurative dhe parime. • Mbikëqyrje procedurë të kadrilit të përmbajtjeve lineare në natyrë; • ekzaminon procedurë të fshirjes me leckë, pambuk, etj., të cilat i mundësojnë fitim të vijave me ton të ndryshëm dhe intensitet të vijave. • Mbikëqyrje, përjeton dhe kompozon piktura nga artistë të njohur nga Maqedonia dhe të huaj, atyre ua verën rolin e vijave në raport me ngjyrën dhe formën.

PIKTURIM (përafërsisht 10 orë)

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ti vërej dhe përdor ne shprehjen e tij figurative, vlerat estetike dhe kolorite ne natyre. • të aftesohet ti verej dallimet dhe komponentët e ambientit vizual dhe iluzionin e ambientit te veprave artistike • të aftesohet te tregoj forma te cilat preken gërshetohen dhe këmbehen; • të përdor dituri të mëparshme për përzierje të ngjyrave dhe pavarësisht të të fitoj ngjyra kromatike dhe akromatike dhe raporte të toneve; • të përdor gjatë pikturimit kontrast komplementar të ngjyrave; • të ketë aftësi të transformojë nga kompozite akromate në kromate dhe anasjelltas; • të bëjë sintezë e të rëndësishmes dhe eliminimin e të parëndësishmes dhe detaje gjatë pikturimit; • të ekzaminoj dhe përdor tekstura të ndryshme pikturore dhe faktuar në krijimtarinë; • ti përvetësoj teknikat e pikturimit me akua-rel, guash, pastel dhe kolazh të njihet me tekniken në letër; • të njihet me disa vepra te themeluesve të pikturës bashkëkohore Maqedonase dhe dy/tre vepra të autorëve të njohura botëror. 	<p>Mjete për vizatim dhe përdorimi i tyre</p> <p>Elemente figurative dhe parimet në vizatimin</p> <p>Pikturim</p> <p>Kolazh</p> <p>Vlerësim estetik</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ngjyra kromatike dhe akromatike • Faturë fotografike • Kompozim figurativ • Kompozim jo figurativ • Valer 	<p>Mbikëqyrë dhe zbulon në formë direkte nga ambienti motive nga shprehja figurative ne ngjyra;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vizaton forma te cilat perputhen, preken dhe zvogelohen dhe shprehin iluzion te ambientit (peizazh, rruge, klase). • Vizaton dhe komponon sipërfaqe me teksturë dhe faturë të ndryshme dhe krijon kompozitë; • Përdor gradim të toneve (valer) dhe vizaton motive nga natyra; • Në teknikën kolazh në formë kreative tregon kontrast të formave, madhësi dhe ngjyra; • Vizaton motive të cilat nëpërmjet ngjyrës shpreh ndjenjë; • Kombinon teknika dhe përdor procedura të ndryshme; • Në vepra figurative vëren kompozim figurativ dhe jo figurativ.

GRAFIKË (përafërsisht 6 orë)

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dijë të vërejë tone akromatike dhe kontraste me ngjyra të errëta – të ndritshme; • të ketë aftësi të zgjidhë vizatime lineare dhe sipërfaqësore me një ngjyrë – monokrome; • të aftësohet të përpunoj monotip me ngjyra kontraste; • të fitoj dituri për grafikën kompjuterike dhe zbatimi i saj; • të ketë njohur në grafikën e printuar në stampim të larte (linoroz, karton shtampe, gipsorez). • të ketë aftësi të dallojë grafikën nga grafika kompjuterike; • të njihet me grafikën reproduktive në një ose dy ngjyra. 	<p>Mjete për printim</p> <p>Elemente figurative në grafikë</p> <p>Grafikë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Grafikë kompjuterike; • Fletë grafike; • Grafikë riprodhuese; • Vulë e lartë; • Vulë e rrafshët. 	<ul style="list-style-type: none"> • E mbikëqyrë mjedisin dhe vëren kontraste me ngjyrë të errët – të ndritshme; • Përdor motive dhe shfrytëzon ideja për shprehje figurative nga mjedisi; • në teknikën monotipi në dy ose më shumë ngjyra paraqet simetri; • me kompjuter krijon grafikë sipas përfytyrimit të tij dhe të njëjtën e printon në printer. • Nëpërmjet printim të vulës së lartë njihet me materialin grafik, veglat dhe mjetet ndihmëse për printim; • në karton vula shton materiale të ndryshme natyrore dhe artificiale për të paraqitur teksturë.

SKULPTURË (PËRAFËRSISHT 6 ORË)

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të njihet me skulpturë miniaturre, galerie ne vend të hapur, skulpturë monumentale; • të dalloj lloje të plastikës së plotë; • të aftësohet në krijimtarinë e madhe – e vogël, e thellë – e cekët, komplete, e performuar e strukturuar; • ti zhvillojë dituritë për fenomenin e figurave tre dimensionale nga ambienti në rrethinë dhe eksperiencat e mëparshme; • të përdor formime të reja, procedura të ndryshme (ndërtim, dhënie, marrje, këputje, krijim, lidhje, lakim, goditje, fërkim etj); • të aftësohet për krijimtarinë nga sende të gatshme (te gjetura) dhe materiale të ndryshme (metal, dru, letër, plastikë), komplet figurativ – asamblaxh; • të njihet me rolin e skulpturës dhe manifestimet e tija në jetën e përditshme shoqërore, kulturore, sociale, profesionale dhe estetike; • të njihet me veprat e tre autorëve të njohur (botëror dhe/ose të vendit). 	<p>Mjete për modelim/ndertim (materiale dhe teknika)</p> <p>Elemente figurative dhe parime në skulpturë (forma, mjedisi, madhësi, strukturë, teksturë, ngjyrë, vija, kompozim, theks, proporcion etj.)</p> <p>Modelim/Ndërtim</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kompozim • Vëllim • Reliev të ceket (barelief) • Reliev të thellë • Plastikë e mbushur • Miniaturë • Skulpturë galerie • Monument 	<ul style="list-style-type: none"> • Nëpërmjet materialit komparativ të njihet me llojet te shprehjeve tre dimensionale (miniaturrë, skulpturë e vogel, skulpturë galeri, skulpturë për vend të hapur dhe monumente); • Ardhja e autorit artistik në shkollë; • Organizimi i grupeve dhe forma në ekipe në krijimtarin; • Të përdor materiale të ndryshme për skulpturë dhe vegla prej druri ose metal, gurë, plastik; • Të përdor materiale të ndryshme atipike, vegla, sende dhe sende te tjera ndihmese.

DIZEJNI DHE KOMUNIKIM VIZUAL (PËRAFËRSISHT 6 ORË)

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi / nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të njohë rëndësinë e bashkimit, të praktikës dhe estetikës për sendet e përdorimit të përditshëm; • të njihet me dizajnin industrial dhe përdorimi i tij në jetën e përditshme; • të aftësohet të përpunojë dizajne për prodhim; • të përdor ornamente, ritëm; • në qëndisjen popullore të njohë forma të stilizuara dhe ta zbulojë simbolikën e tyre; • të përdor kompjuter për përpunimin e dizejnit. 	<p>Elemente figurative dhe parime në dizejnin dhe komunikimet vizuale</p> <p>Dizejnit</p> <p>Komunikime vizuale</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ambalazh • Mbështjellëse • Ornament • Dizejnit industrial • Arte të përdorura 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbikëqyrë vepra nga dizejnit industrial dhe grafik; • Shikon ambalazhe dhe mbështjellëse, e vëren dizejnin; • Përpunon vizatim për ambalazh; • Përpunon vizatim për mbështjellëse; • Përdor ritëm dhe vizaton dizenë; • Stilizon forme nga flora dhe fauna dhe e përdor në shprehjen figurative; • Dekoron sende të ndryshme dekorative (gota, pjata, qypa, shishe, vazo të vogla etj.); • E përdor ornamentin; • Përdor materiale dhe teknika të vizatuara, të fotografuara dhe të skulpturuar dhe të njëjtat i kombinon sipas dëshirës.

5. REKOMANDIME DIDAKTIKE

• Përbajtjet mësimore në lëndën arsimit figurativ për klasën e VII për arsimin fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e VII për arsimin fillor nëntëvjeçar japin mundësi për integrim të plotë dhe lidhshmëri përbajtësore me lëndët mësimore: gjuhë amtare, matematikë, gjuhë angleze, njohja e mjedisit, arsimit muzikor dhe arsimit fizik. Gjithashtu, jepen mundësitë për planifikim të brendshëm të integruar për të gjitha temat në përputhje me nevojat e nxënësve dhe aktivitetet e planifikuara.

Fondi vjetor i orëve

TEMAT		Numri i orëve
1	Vizatim	8
2	Pikturim	10
3	Grafikë	6
4	Skulpturë	6
5	Dizejn dhe komunikime vizuale	6
		36

Vërejte: Numri i orëve është dhënë në formë orientuese.

Mjetet mësimore:

- burime të ndryshme të mëimit nga mjedisi i drejtpërdrejtë (gjësende në natyrë dhe mjedis);
- mjete dhe materiale didaktike;
- mjete vizuale (gjësende nga mjedisi i drejtpërdrejtë, riprodhime, krijime të fëmijëve, aplikacione etj);
- sllajde, ilustrime, revista etj;
- mjete audio-vizuale (TV, DVD-pleer, videopleer, fotoaparati digjital, kamerë digjitale, kompjuter dhe mjete tjera varësisht nga lënda);
- Internet, softuere arsimore.

6. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Gjatë procesit mësimor rregullisht përcillen dhe vlerësohen të arriturat e nxënësve, përmbledhen treguesit e aktiviteteve të tyre, motivimi për krijim figurativ, bashkëpunim kolektiv etj. Gjatë vitit nxënësit marrin nota numerike.

Kjo komponentë është pjesë përbërëse e planifikimit të mësimdhënësit për mësimin dhe të mësuarit.

- Vlerësimi:
 - përshkrim verbal i vizatimit personal;
 - shkalla e zotërimit të teknikave figurative;
 - pjesëmarrje dhe ekspozitë e krijimeve figurative;
 - studimi dhe njohja e gjësendeve të ndryshme në mjedisin e drejtpërdrejtë dhe zbatimin në krijimtarinë figurative;
 - njohja e teknikave dhe materialeve figurative;
 - pjesëmarrje aktive në punën në grupe etj.

7. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi sa i përket kushteve hapësinore bazohet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe mjete mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar i miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me Vendim nr. 07-1830/1 më 28.02.2008.

8. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Puna edukative-arsimore në klasën e VI në arsimin fillor tetëvjeçar, përkatësisht në klasën e VII në arsimin fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi i cili ka të kryer:

- Fakultetin e artit figurativ- drejtimin e teorisë muzikore dhe pedagogjisë;
- Fakultetin e artit figurativ- drejtime tjera me rikualifikim të arritur pedagogjiko-metodike.

Programi mësimor i *artit figurativ* për klasën e gjashtë në arsimin fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e shtatë në arsimin fillor nëntëvjeçar e solli ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 01-2327/1 od 15.03.2008